

TERMAT E REFERENCËS

”Ndertimi i nje Ure te Varur dhe rikonstruksioni i nje Ure Automobilistike ”BASHKIA e URES VAJGURORE ”

1. HYRJE/ POZICIONI GJEOGRAFIK DHE INFORMACIONI I PËRGJITHSHËM

Bashkia e Urës Vajgurore i takon administrativisht Qarkut Beratit, një prej dymbëdhjetë Qarqeve. Ky qark ndodhet në Jug të Vendit dhe ka kryeqendër qytetin e Beratit.

Bashkia e Urës Vajgurore zë pjesën veriperëndimore të Qarkut dhe kufizohet në Veriperëndim dhe Perëndim-Jugperëndim me Bashkinë e Lushnjës dhe Roskovecit të Rajonit fqinjë. Në Verilindje dhe Jug lindje kufizohet me Bashkinë e Kucovës dhe Beratit pjesë e të njëjtit qark. Sipërfaqja e Bashkisë është 15,680 ha.


Kryeqendra e Bashkisë së Urës Vajgurore është qyteti homonim. Në reformën e fundit territoriale ligjinr.115 të vitit 2014 kjo Bashki përfshin këto ish-Bashki:

-Ish Bashkinë e Urës Vajgurore me qytetin homonim, së bashku me fshatrat Bistrovicë, Konisbalte, Pashalli, Vokopole dhe Skrevan.

-Ish Bashkinë Poshnje, e cila përfaqëson fshatrat Poshnje, Polizhan, Ciflik, Arres, Banaj, Gajde, Malas Gropore, Syzez, Sheq Gajde, Hinge dhe Kuc.

-Ish Bashkinë Kutalli, e cila përfshin fshatrat Kutalli, Sqepur, Drenovicë, Samaticë, Pobrat, Rerez, Protoduar, Gorican Qender, Gorican Clirim dhe Malas Breg.

-Ish Bashkinë Cukalat e cila përfshin fshatrat e Donofrosë, Slanice, Cukalat, Allambres, Krotinë dhe Cete.



Hartë me Bashkitë Perreth Ure Vajgurore.

Pozita gjeografike e Bashkisë është e rëndësishme. Ajo shtrihet në afersi të bregut Perëndimor të vendit dhe është e lidhur me rrugë me qendrat afërta urbane , si Fier dhe Lushnje. Rruga kryesore kombëtare SH72 që lidhet me qytetin e Lushnjes, SH73 ofron lidhje me Roskovecin dhe Fierin.

Afërsia me bregdetin është avantazh pasi ka qasje të shpejtë me portin e Vlores dhe Durrësit.

Kjo vendhje gjeografike e bën Bashkinë e Urës Vajgurore “ Një Lidhëse “ mes qytetit te Beratit dhe Kucovës

Në nivel rajonal ka avantazh afërsine me zonën Urbane Berat-Kucovë dhe relativisht afër Kryeqytetit Tirana.

Marrëdhëniet me Rajonin kryesisht me Kucovën pasi një pjesë e madhe e aktivitetit Ekonomik të Bashkisë ka lidhje me aktivitet e nxjerrjes naftës, nxjerrjes gurit etj. Zhvillimi ekonomik lidhet ngushtë dhe me sektorin Bujqësor dhe Agrikulture dhe përpunimin e ketyre Prodhimeve.

2. OBJEKTIVAT

Me Vendimin të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 03 date 08.02.2017 është miratuar Plani i Përgjithshem Vendor.Bazuar në kuadrin referues të PPV mbi projektet e zhvillimit dhe

zhvillimin strategjik te Bashkise Ura Vajguore ka prioritet ndërtimin e ketyre dy urave me qëllim përmirësimit estetik, funksional, zhvillimin Policentrik dhe lehtësimin e lëvizshmërisë së qytetarëve në këtë Qender Urbane. Bazuar në këtë studim perfshihet rikonceptimi i dy urave ekzistuese të ndërtuara mbi lumin “Osum”, Rikonstruksioni i automobilistike” në hyrje të zonës. Ura tjetëre Varur që është 300 m më në jug e pa përdorshme që ka patur funksion industrial për kalimin e tubacionit të ujit dhe lendeve djegese per Ish-Kombinatit. Kjo urë ndihmon komunikimin më të shpejtë dy anëve të Qendrës Urbane sidomos për pjesën e Kopshteve të femijeve, nxënësve të shkollave 9-vjecare dhe të Gjimnazit.

Qëllimi i ketij shërbimi është ofrimi i shërbimeve inxhinierike në lidhje me Projektimin I Ri UreVarur dhe Rikonstruksion dhe përmirësimi elementëve Ura Automobilistike.Konsulenti duhet të ofroje shërbimin konsulencës sipas Fazave:

Faza e II-të Projekti de jure

Faza e III-tëProjekti de jure përfundimtare

Faza e IV-ërt Projekti për miratimin e Lejes së Ndertimit

Fazae e V-të Projekti i zbatimit

Faza e VI-tëPreventivi Përfundimtar dhe

Faza e VII-të Përgatitja e dokumentacionit për procedure tenderimi

3. QELLIMI I PUNES

Të dy urat, realizojnë lidhjen e pjesës perendimore të qytetit me ate lindore. Mbi bazen e transformimeve që po pëson kjo Qender Urbane dhe dimensionit të ri që po synohet të krijohet, këto ura nuk plotësojnë parametrat për funksionimin normal të tyre. Në këtë kuadër propozohet ndërtimi i Urës sëVarur po ku është Ura e vjetër e varur Kombinatit e ndërtuar që në kohën e Italisë vitet 1930 që nuk mund të kthehet në destinacion për kalim këmbësorësh për shkak të amortizimit të elemntëve konstruktivë, kavot e celikut, kollonat e betonit.Rikonstruksioni i urës automobilistike ekzistuese e ndërtuar në vitet 1970 (përmirësim konstruktiv dhe estetik, masa mbrojtese per largimin e ujrave dhe agjenteve atmosferik, trotuare ndricim publik). Ky projekt do të realizohet me fondet e vet Bashkisë Urës Vajguore.

3.1 Projektimi i 2 Urave

Ura e re e Varur, që do të ndërtohet është e pozicionuar në kryqezimin e fillimit rrugës “Lluk Mita” me rrugën perkrah lumit “ Guri Bardhë”, ku është aktualisht ura e vjeter e varur e ndërtuar rreth viteve 1930 per Kombinatit per nevoja teknologjike dhe nuk janë bërë investime për mirëmbajtje në tërë vitet e funksionimit të saj. Ura ka patur funksion

transport tubacione për kombinatin. Sot ajo paraqitet e amortizuar në elementet e saj konstruktiv dhe nuk mund të rikonstruktohet . Duke marrë në konsideratë faktin që zona ku shtrihet kjo urë është zhvilluar nga ana urbane, industriale, tregtare etj, del domosdoshmeri zgjerimi dhe rikonstruksioni i saj i cili do të plotesojë anën funksionale, arkitektonike, urbane per arsyjet si më poshtë:

- a) Eshtë ura kryesore lidhese në dy anët e lumit për këmbësorët për një shpërndarje të balancuar hapësinore.
- b) Fluksi i lëvizjeve për shkak të intitucioneve arsimore dhe administrative që do të hyjnë dhe dalin nga kjo urë është i madh sidomos në oret e para të ditës.
- c) Struktura mbajtëse si dhe gjendja ekzistuese nuk garanton funksionimin për levizjen e mjeteve të lehta të transportit sipas studimit miratuar për rikonceptimin e Qëndres së Qytetit.

Ura automobilistike, është ndërtuar rreth viteve 1970 në krahun verior të qendrës banuar ku ura automobilistike shërben për trafikun transit nga Poshnja ne drejtim te qytetit Kucovës dhe Beratit. Ura është ndertuar me trare të parapregatitur beton-arme me 3 pila masive beton-arme dhe me funksion kalim automjete dhe këmbësorëve. Gjerësia e ures eshte 10.0 m dy korsi kalimi automjesh 3.5m+3.5m dhe 1.5m+1.5m trotuar, me shtrirje rreth 100 ml, e konturuar me parapet konstrukcion metalik dhe guard-rail per mbrojtjen e kembesoreve nga te dy anet e saj. Shtresa kaluese e ures eshte ne gjendje te mire pasi eshte riveshur me shtresa asfaltike ne vitet e fundit, nuk kemi deformacione ne pjeses kaluese te cilat veshtiresojne levizjen normale te automjeteve, amortizim ka pjesa pergjate trotuareveku duhen marre masa per elementet e rifinitures dhe largimit te ujrave pasi dhe me moshen e ures ato edmtojne duke depertuar tek traret mbahtes . Duke marre ne konsiderate qe kjo ure ka nje kujtese historike dhe raport shume te favorshem me pjesen tjeter te qytetit, del domosdoshmeri rikonstruksioni i saj dhe rikonceptimi ne harmoni me objektet ekzistuse.

Ne rikonceptimin e qendres jane parashikuar dhe ndertimi i ketyre dy urave

Bashkalidhurjanëmaterialehartografike:

1. *Harta e pozicionimit të tre urave në raport me studimin e qendrës së qytetit*
2. *Harta e zgjidhjes së fluksit të lëvizjes*

Për vazhdimin e mëtejshëm të materialit përshkrimor, urat do të emërtohen si më poshtë:

URA 1 ne vendin e quajtur (Ura e ish-Kombinatit)



Open
Procurement
Albania

URA 2(Ura Automobilistike Vajguore ne Hyrje te zones banuar)



Në mënyrë të vecantë konsulenti do të studiojë, duke marrë në konsideratë, si më poshtë:

- Urat nuk duhet të prishin vazhdueshmërinë e seksionit të rikualifikuar të shtratit të lumit Osum.
- Në mbështetje të Studimit të Rikonceptimit të Qendrës së qytetit projektuesi të japë ide dhe gjykime mbi anën estetike të urave.
- Ura automobilistike të rikonstruktohet si urë prej baeton-arme. Do të rakordohentrotuaret dhe elementë të tjerë urban.
- Ura e Varur do te kete karakter turistik dhe elemente arkitekture bashkekohor.
- Urat duhet të jenë të shoqerohen me të gjitha elementet dhe kërkesat Urbane, si korsi biçikletash, Sinjalistikë horizontale e vertikale, Ndriçim etj.

4. QELLIMI DHE KËRKESAT QË DUHET TË PLOTËSOJË PROJEKTI

Konsulenti duhet të studiojë dhe të marrë në konsideratë çdo projekt apo studim që ka të bëjë me objektin e kësaj kontrate. Konsulenti për realizimin e detyrës tij duhet të studiojë dhe të marrë në konsideratë situatën gjeologjike, hidrologjike dhe në mbështetje të tyre të marrë masat e nevojshme inxhinierike. Ai duhet të mbështetet dhe të zbatojë legjislacionin shqiptar për këtë qëllim.

Konsulenti duhet të mbështetet dhe të konsultohet me Standartin Shqiptar të projektimit

të veprave të artit në rrugë “RREGULLI TEKNIK PËR PROJEKTIMIN E RRUGËVE”, veçanërisht Vëllimi 5. Lidhur me parametrat gjeometrikë urat do të konceptohen si më poshtë:

Konsulenti duhet të bëjë dhe një analizë ekonomike të fazave të projektit duke u mbështetur në llogaritjet e vizatimeve dhe terrenit duke paraqitur Analize Para-Fizibiliteti dhe duke përdorur çmimet e miratuara me V.K.M.

5. KËRKESAT PËR KONSULENTIN DHE RAPORTET

Gjatë kësaj faze konsulenti duhet të përfshijë aktivitetet e mëposhtme kryerjen e vëzhgimeve dhe përditësimin e llogaritjeve, si më poshtë:

- Përgatitjen e metodologjisë së përgjithshme të ndërtimit.
- Përgatitjen e programit të punimeve.
- Përgatitjen e vlerësimit të kostos.
- Konsultimin me Autoritetin Kontraktor.

Konsulenti duhet të paraqesë vizatimet e mëposhtme duke organizuar pjesën bazë të dokumentave të kontratës për zbatimin e punimeve.

- Horografia në shkallën 1: 10 000, 1:5000, ose 1:2000. Në raste që zona e studimit është shumë e madhe duhet të përgatitet një hartë përmbledhëse në një shkallë të përshtatëshme.
- Planimetri e Urave në shkallë 1:500; 1:200 etj.
- Profil gjatësor, tërthor Shkallë: 1:100, 1:50 etj.
- Volumet e punës dhe Preventivi.

Konsulenti do të përgatisë volumet e punës respektive për të gjithë kategoritë e punëve të paraqitura në projekt. Volumet do të llogariten në bazë të vizatimeve të projektit. Çmimet njësi për të gjitha punimet përkatëse do të llogariten duke pasur parasysh çmimet mesatare të miratuara me VKM dhe ato që nuk gjenden në manuale të shoqërohen me analiza teknike. Raporti i Projekt Idesë mbasi firmoset dhe vuloset nga specialistët e firmës konsulente paraqitet tek Autoriteti Kontraktor në formë zyrtare për shqyrtim dhe miratim.

Rilevimi topografik dhe gjeologjia do të hartohen si studime nga Konsulenti ndërsa Hidrologjia do të merret e mireqene nga materialet që do të vendosen në dispozicion Autoriteti Kontraktor.

5.1 Kërkesat për Projekt – Zbatimin

Në këtë fazë pasmiratimit të projekt idesë nga Autoriteti Kontraktor, Konsulenti do të hartojë projektin e zbatimit i cili përfshin përgatitjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm.

5.1.1 Raportet

a. Raporti Përfundimtar i studimit Topografik

Projekti dhe Raporti përfundimtar i Studimit Topografik duhet të përmbajë të gjithë informacionin e rëndësishëm topografik i cili nevojitet gjatë fazës së hartimit të projektit të zbatimit si dhe të asaj së zbatimit të punimeve me një fasho 100 ne te dy krahet e ures.

- a) Zgjidhja përfundimtare e miratuar duhet që për këtë fazë të fiksohet edhe në terren nëpërmjet pikave kryesore të rrjetit koordinativ, të cilat duhet të kenë:
Koordinatat dhe kuotat përkatëse. Këto pika do t'i shërbejnë ndërtuesit për piketimin përfundimtar të aksit në terren si dhe informacion topograafik teinfrastruktues egzistuese, Linja ujesjellsit-tubacione iindustriale, elektrike, telefoni etj.
- b) Të gjitha kuotat do të jenë absolute dhe të fiksuara në repera fikse betoni
- c) Konkluzionet dhe rekomandimet e grupit të studimit të pasqyruara me Raport Teknik

b. Raporti Ndikimit ne Mjedis

Përgatitja e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis kërkohet që të përputhet me kërkesën e Ligjit Kombëtar për të marrë Leje Mjedisore. VNM duhet të përfshijë një raport të matjeve që kontraktuesit e punës duhet të marrin gjatë fazës së zbatimit të projektit dhe Ndikimi i ndërtimit të projektit gjatë dhe pas përfundimit të punimeve. Ky raport duhet të plotësojë kërkesat e ligjit për marrjen e lejes së nevojshme nga Ministria e Mjedisit dhe agjencitë përkatëse përgjegjëse dhe gjithashtu duhet të respektojë rregulloret e BE. Aspektet sociale duhet të trajtohen, posaçërisht ndertimin e ketyre dy Urave dhe disa aktivitete të shpronësimit do të ndodhin ose nga Ente Shtetore të cilat kanë ne pronesi asete të ish-Kombinatit Maocedun apo dhe prona private.

c. Koncepti Arkitektonik

Koncepti arkitektonik duhet të mbështetet nga një komunikim fluid me informacionin inxhinierik, si një formë e vetme e konsoliduar, e thjeshtë dhe rigoroze.

Urat duhet të kthehen në kuverta të hapura dhe të mbrojtura, jo vetëm si pasazhe të makinave dhe qytetareve por edhe si pika vrojtimi të mjedisit përreth. Struktura Inxhinierike Beton-arme apo Çelik duhet të shërbejë ndër të tjera, si impuls dhe element arkitekturor, e lehtësuar me panele transparente lineare, të harkuara apo të lakuara dhe të mundshme për të siguruar pjerresi të pershtatshme të një hapje skenografike të qytetit për kembesoret dhe ciklistet kryesisht.

Materialet qe duhet te perdoren kryesisht duhet te manifestojne ate cka eshte e natyrshme, dhe materialisht te aferta me ate cka pershtatet me vendin dhe kohen. Materialet kryesore, mund te jene betoni i perpunuar, konglomerate me guret e zonave te aferta, Celik, korten dhe parete xhami transparente.

Ne te njejten kohe, Urat duhet te kthehen ne fenere orientues dhe pika fokale per qytetin. Ndricimi artificial duhet te jete nje element i rendesishem arkitekturor, dhe bashkethemelues ne idene e konceptin fillestar te projektit. Ndricimi mund te intersektohet ne objekt me orare te kufizuara (nga ora 19:00. në orën 02:00) duke mundesuar theksimin e linjave dhe zhvillimit volumetrik te ndertimit, me nje shkelqim te vecante dhe unik per kete zone.

d. Studimit Hidrologjik

Konsulenti duhet te marre te mireqene te dhenat historike metreologjike dhe Studime perkatese te furnizuara nga Autoriteti Kontraktor per te percaktuar nivelin maksimal dhe minial te Lumit Osum ku do te vendosi dhe per pozicionimin e Kuotave te Zhvillimit te Ures.

Hidrologjia dhe Rakordimet me Lumin

Ne pikat ku ndodhen urat behet ne vend rakordimi i shtratit te sistemuar te lumit Osum me keto ura pa zvogeluar aftesine traspotuse hidraulike te parashikuar ne projektin e lumit .

e. Raporti përfundimtar i Projektit Elektrik

Konsulenti duhet te marre ne konsiderate te gjithe te dhenat per infrastrukture egzistuese elektrike, dhe ne piken me te afert do bejte te mundur lidhjen me rrjetin publik te qytetit per te mundesuar nje ndricim te sigurte dhe bashkohehor ne bashkepunim me Arkitektin do dakordesohen tipologjia e ndricimit aposisteme te ndyshme te automatizuara per kontrollin e Ndricimit apo dhe levizjes se mjeteve apo kembesoreve.

Ne fund do te pergatitet Raport Tekniki, konkluzionet dhe rekomandimet e studimit.

f. Raporti përfundimtar i Studimit Gjeoteknik

Konsulenti në pregatitjen e këtij raporti duhet të rishikojë edhe një herë raportin Gjeoteknik të pregatitur në fazën e projekt-idesë duke e plotësuar atë me informacione shtesë apo të dala gjatë shqyrtimit të sajë nga Autoriteti Kontraktor. Raporti i Studimit Gjeoteknik duhet të përpilohet për secilën dukuri fiziko-gjeologjike të trajtuar dhe për secilin objekt. Raporti i Studimit Gjeoteknik do të ketë përmbajtjen si më poshtë:

- a) Raport Teknik, parametrat gjeoteknik të projektimit, konkluzionet dhe rekomandimet e grupit të studimit.
- b) materiali grafik, harta, planimetritë, prerjet gjologo-inxhinierike dhe në mënyrë të

vecantë harta dhe kordinatat shpimeve.

g. Raporti përfundimtar i Studimit Infrastruktures rrugore dhe aksesit

Konsulenti në përgatitjen e këtij raporti duhet të marre perbaze projekt-idenë duke e plotësuar atë me informacione shtesë apo të dala gjatë shqyrtimit të sajë nga Autoriteti Kontraktor. Raporti Infrastruktura duhet të përmbajezgjidhjet dhe rakordimet hyrese dalese. Raporti i Studimit do të ketë përmbajtjen si më poshtë:

- c) Raport Teknik, parametrat gjeometrik të seksioneve, konkluzionet dhe zgjidhjet ne perputhje me arkitekturen.
- d) Materiali grafik, harta, planimetritë, prerjet profilet gjatesore dhe terthore inxhinierike.

h. Volumet e punës dhe Preventivi

Bazuar në llogaritjet dhe vizatimet e projektit Konsulenti do të hartojë një listë me të gjitha zërat e punimeve që janë pjesë përbërëse e listës përfundimtare të volumeve (Preventivi). Preventivi do të shoqërohet me tabelat e volumeve dhe menyrën e llogaritjes tyre. Cmimet do të jenë ato njësi të miratuara me VKM. Zërat e punimeve që nuk janë përfshirë në listën e cmimeve njësi të miratuar Konsulenti do ti shoqëroje me analizën e llogaritjes cmimit.

i. Përgatitja e Raportit Konstruktiv

Mbështetur në raportet e mësipërme Konsulenti duhet të paraqesë raportin Konstruktiv, të objekteve pjesë e kësaj detyre. Në raport duhet të jepen, Normat mbi të cillën janë kryer llogaritjet, Përshkrimi i skemës strukturore, karakteristikat e materialeve si edhe të dhëna të tjera që janë përdorur për llogaritjen e strukturave të urave. Në këtë raport duhet të pasqyrohen në një pjesë të veçantë dhe rezultatet kryesore të llogaritjeve

5.1.2 Përgatitja e metodologjisë të punimeve të ndërtimit

Mbas përfundimit të projektit të zbatimit, Konsulenti duhet të kryejë rishikimin e metodologjisë së ndërtimit. Metodologjia e ndërtimit ndërmjet të tjerave duhet ti referohet dhe problemeve të teknologjisë së ndërtimit dhe çështjeve mjedisore.

Në këtë fazë gjithashtu, konsulenti do të përshkruajë dhe punimet ndihmëse, nevojat e ndërtimit të rrugëve të shërbimit të spostimeve të ndryshme elektrike telefonike apo tjera që dalin gjatë ndërtimit të veprës.

5.1.3 Vizatimet

Konsulenti në fazën e projektit të zbatimit në formë grafike duhet të vizatimet e mëposhtme duke organizuar pjesën bazë të dokumentave të kontratës për zbatimin e punimeve.

- Horografia në shkallen 1: 10 000, 1:5000, ose 1:2000. Në raste që zona e studimit

është shumë e madhe duhet të përgatitet një hartë përmbledhëse në një shkallë të përshtatëshme.

- Planimetri e Urave në shkallë 1:500; 1:200 etj.
- Profil gjatësor, tërthor Shkallë: 1:100, 1:50 etj.
- Rilevimi topografik Shkallë 1:500; 1:200
- Harta gjeologjike SH 1:1 000; 1:500; 1:200.
- Volumet e punës dhe Preventivi.

5.1.4 Dokumentat e Tenderit

Konsulenti do të realizojë të gjithë dokumentacionin e tenderit. Dokumentat përfundimtare të tenderit do të përfshijnë:

- a. Udhezime për ofertuesit;
- b. Kushtet e Pergjithshme të Kontrates;
- c. Kushtet e Vecanta të Kontrates;
- d. Specifikimet dhe Vizatimet;
- e. Pasqyrat e Sasive;
- f. Format për dorëzimin e ofertave, pranimit të ofertave, pagesat e sigurimeve, draft kontratën, certifikatat e lehuara nga Punedhësi, etj.

Një dokumentacion kontrate draft, do të dorëzohet Bashkisë për miratim. Pas miratimit të dokumentacionit nga Bashkia, Konsulenti do të përgatisë dokumentacionin përfundimtar të tenderit, duke përfshirë Specifikimet Teknike dhe Dokumentacionin e Kontrates.

6. KOHEZGJATJA E KONTRATES

Shërbimi është vlerësuar për të filluar në Prill 2019 dhe do të përfundojë deri në fund të Qershor 2019.

7. STAFI KRYESOR

Stafikryesor minimal i kërkuar është si vijon:

1. Drejtues i Projektit një specialist inxhinjer ndertimi, i specializuar për hartimin e dokumentave të tenderit në fushën e infrastrukurës me eksperiencë mbi 25 vite pune.
2. Specialist Arkitekt me eksperiencë mbi 15 vjet në projektimin dhe zhvillimin e planeve vendore .
3. Specialist inxhinjer Konstruktor me eksperiencë mbi 25 vjet në projektimin e Urave të Varura, Metalike.
4. Specialist inxhinjer Hidroteknik me eksperiencë mbi 25 vjet në supervizion dhe

projektim.

5. Specialist Inxhinier Elektrik me eksperience mbi 25 vjet në projektimin e linjave të ndricimit publik, tensionit te ulet, te mesem dhe sinjalistike ndricuese.
6. Specialist inxhinier infrastrukture transporti me eksperience mbi 10 vjet ne projektimin e rrugeve urbane dhe sinjalistikes rrugore.
7. Specialist inxhinier Mjedisi dhe Licence per Vleresimin e Pasurive te Palujtshme, me eksperience mbi 10 vjet ne hartimin e Raporteve te Ndikimit ne Mjedis.
8. Specialist inxhinier Topograf me eksperience mbi 20 vjet ne rilevime inxhinierike dhe bazamenteve Gjeodezike.
9. Specialist Gjeologo Inxhinjerik – Hidrogjeologjik me eksperience mbi 25 vjet ne projekte gjeologo inxhinjerike.

Pergatiti



Miratohet
Kryetari i bashkise